

**SHOQERIA "LIBERTY TRAVEL" sh.p.k.**

**SHOQERIA "FC ALBANIA" sh.p.k.**


**MARREVESHJE**

**Date 30.09.2024**

Ne reference te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe Ligji Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", me cilesine e Administratoreve te shoqerive te cilat do te perthithen, deklarojme se:

Pas nje shqyrtimi te detajuar te veprimtarise ekonomike, financiare dhe ligjore te shoqerive, pasi ortaket kane vleresuar si te pershtatshme dhe me interes perthithjen e shoqerise "FC ALBANIA" sh.p.k. nga shoqeria "LIBERTY TRAVEL" sh.p.k., ne cilesine e administratoreve te shoqerive qe perthithen dhe attributeve qe na jep Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", dhe Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", hartuam kete marreveshje bashkimi nepermjet perthithjes se shoqerive "LIBERTY TRAVEL" sh.p.k., dhe shoqerise "FC ALBANIA" sh.p.k., mbeshtetur ne legjislacionin e mesiperm.

1. Shoqeria "LIBERTY TRAVEL" sh.p.k. do te jete shoqeria perthithese e shenuar ne vijim dhe si shoqeria perfituese e kontributeve, me seli, Tirane.
2. Shoqeria "FC ALBANIA" sh.p.k. do te jete shoqeria e perthithur e shenuar ne vijim edhe si shoqeria kontribuese, me seli, Tirane.
3. Palet jane dakord qe Shoqeria "FC Albania" sh.p.k. te perthithet nga Shoqeria "LIBERTY TRAVEL" sh.p.k. duke transferuar teresine e elementeve te aktivitetit dhe te pasivitetit qe jane prezantuar ne bilancin dhe pasqyrat financiare te shoqerise ne gjendjen ne te cilen ndodhet kjo trashëgimi tek shoqeria perfituese "LIBERTY TRAVEL" sh.p.k.
4. Kapitali i shoqerise perfituese e kontributeve (shoqerise perthithese), pas realizimit te procesit te bashkimit me perthithje me shoqerine "FC Albania" sh.p.k. (shoqeria kontribuese) do te perbehet nga kapitalet e seciles prej shoqerive ne momentin e realizimit te ketij procesi, ne vlere 6,100,000 leke, i perbere nga 2 kuota me vlere 3,050,000 leke secila kuote, vlere e cila eshte percaktuar ne raportin e auditueses per modalitetet e bashkimit dhe vleresimin e kapitaleve



te dy shoqerive "FC ALBANIA" sh.p.k. dhe "LIBERTY TRAVEL" sh.p.k.

5. Bashkimi me perthithje i shoqerive "LIBERTY TRAVEL" sh.p.k. dhe "FC ALBANIA" sh.p.k. do te sjelle për ortakët e shoqërisë "FC ALBANIA" sh.p.k. (shoqëria kontribuese) marrjen e cilësisë së ortakut në shoqërinë "LIBERTY TRAVEL" sh.p.k. (shoqëria përfituese e kontributeve), duke zotëruar secili nga 50 % të kapitalit të shoqërisë nga ku ortakut Hamdy Abouhassan zotëron një kuotë me vlerë 3,050,000 leke dhe ortakut Marselinda Kortoçi zotëron një kuotë me vlerë 3,050,000 leke.
6. Te drejtat dhe detyrimet e shoqërisë së perthithur "LIBERTY TRAVEL" sh.p.k. do t'i kalojnë shoqërisë perthithëse "FC ALBANIA" sh.p.k., pas përfundimit të operacionit.
7. Data e vendimit të ortakëve të shoqërisë, do të quhet sipas ligjit, data pas së cilës operacionet e shoqërisë së perthithur "FC ALBANIA" sh.p.k. do të konsiderohen, në aspektin e kontabilitetit, si të kryera nga shoqëria që përfiton kontributet (shoqëria "LIBERTY TRAVEL" sh.p.k.).
8. Shoqëria "FC ALBANIA" sh.p.k. si shoqëri e perthithur nga shoqëria "LIBERTY TRAVEL" sh.p.k. në përfundim të këtij procesi do të priset pa likuidim duke kaluar plotësisht trashëgiminë e saj ekonomike, financiare dhe ligjore tek shoqëria përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit.
9. Selia e shoqërisë përfituese të kontributeve, do të jetë në adresë Rr. Reshit Collaku, hyrja 7, ap. 8, pasuria nr.7/135+7-88ZK.8380VOL.9, FQ.165, Tiranë.
10. Administrator i shoqërisë Hamdy Abouhassan.
11. Bashkimi do të hyjë në fuqi në datën e mbledhjes së fundit të Shoqërisë që do të miratojë operacionin.

Duke iu referuar Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", dhe Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit" është përgjegjësia e Administratoreve të dy shoqërive të cilat bashkohen, për të realizuar publikimin e tij sipas ligjit.

"LIBERTY TRAVEL" sh.p.k.

Administrator

Hamdy Abouhassan

LIBERTY TRAVEL  
NUTS: L 42412003 A  
Cet: 06/2016166  
Tirana - Albania

"FC ALBANIA" sh.p.k.

Administrator

Marselinda Kortoçi

FLIGHT CENTER ALBANIA  
Sh.p.k.  
NUTS: L 82124001Q